



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
Ministri

41347
Nr. Prot.

Tiranë, më 10.08.2011

URDHËR

Nr. 388 datë 10.08.2011

PËR

**HAPJEN E PROGRAMEVE TË REJA TË STUDIMIT “MASTER
PROFESIONAL” E “MASTER I SHKENCAVE” DHE FILLIMIN E
VEPRIMTARISË AKADEMIKE PËR KËTO PROGRAME, PRANË SHKOLLËS
SË LARTË TË ARSIMIT PRIVAT “PAVARËSIA”, VLORË.**

Në mbështetje të Nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; Ligjit Nr. 9741, datë 21.05.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe VKM Nr 279, datë 12.03.2009 “Për dhënien e lejes për hapjen e shkollës private të arsimit të lartë , “Pavarësia”, Vlorë ,

URDHËROJ:

1. Hapjen pranë Fakultetit të Ekonomisë dhe të Shkencave Shoqërore të shkollës private të arsimit të lartë, “Pavarësia”, Vlorë, dhe fillimin e veprimtarisë akademike të programeve të reja të studimit, të Ciklit të Dytë, në përfundim të të cilëve lëshohet diplomë universitare:
 - a) “Master Profesional” që realizohen me 60 kredite, në formën e studimit me kohë të plotë në:
 - i. “Specialist i së drejtës për shoqëritë tregtare”;
 - ii. “Specialist i së drejtës për sistemin bankar”;
 - iii. “Specialist i së drejtës për Administratën Publike”;
 - iv. “Financë bankë”;
 - v. “Financë dhe Kontabiliteti i firmave”;
 - b) “Master i Shkencave”, që realizohet me 120 kredite, në formën e studimit me kohë të plotë në “Financa Publike dhe Administrim Publik”;

2. Hapjen pranë Fakultetit të e Shkencave të Aplikuara të shkollës private të arsimit të lartë, "Pavarësia", Vlorë, dhe fillimin e veprimtarisë akademike të programeve të reja të studimit, të Ciklit të Dytë, në përfundim të të cilëve lëshohet diplomë universitare:
 - a) "Master Profesional" që realizohen me 60 kredite, në formën e studimit me kohë të plotë në:
 - i. "Aplikime sistemesh informative në Administratën Publike";
 - ii. "Administrim sistemesh dhe rrjetesh"
 - iii. "Specialist programues sistemesh software",
 - b) "Master i Shkencave" që realizohen me 120 kredite, në formën e studimit me kohë të plotë në:
 - i. "Inxhinieri informatike";
 - ii. "Informatikë ekonomike".
3. Programet e studimit sipas pikave 1.a.i, 1.a.ii, 1.a.iii e 2.b.i të këtij Urdhri, hapen në bazë të Vendimit Nr. 149 datë 18.02.2011 dhe programet e studimit sipas pikave 1.a.iv, 1.a.v, 1.b e 2.a.i, 2.a.ii, 2.a.iii e 2.b.ii të këtij Urdhri, hapen në bazë të Vendimit nr. 173 datë 15.04.2011 të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë, bashkëlidhur këtij Urdhri;
4. Shkolla private e arsimit të lartë "Pavarësia", Vlorë, duhet t'i nënshtrohet procesit të akreditimit të këtyre programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi;
5. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij urdhri;
6. Ngarkohet për zbatimin e këtij Urdhri Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Zhvillimit të Arsimit Jopublik dhe shkolla private e arsimit të lartë "Pavarësia", Vlorë.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MYQEREM TAFAJ


MINISTËR

